



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e pestë e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e mbajtur me datën 26.05.2026, në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vlonjat Hasani - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Festim Pllana, Daut Krasniqi, Kushtrim Mirena, Kosovar Ademi, Besarta Qadraku, Filloreta Musaj, Arlinda Mekolli, Rrahim Sogojeva, Hajredin Mjeku, Afrim Dumani, Laureat Gojnovci, Jetmir Berisha, Burim Berisha, Ali Topalli, Etnik Berjani, Saranda Sllamniku, Vjosa Kida Hyseni, Mirlinda Krasniqi, Rrahim Tërnavë, Valon Murseli, Ermal Dumani, Aida Alimi, Dardane Sogojeva Shala, Migjen Kolshi, Suhat Ademi, Dashnim Bajrami, Ali Ismaili, Driton Ademi, Gjelbrim Halili dhe Radoman Doderovic.

Prezentë nga Ekzekutivi i Komunës: Vildane Latifi - Drejtoresha e Administratës, Bardhyl Koicici - Drejtor për Buxhet dhe Financa, Izja Mjeku - Drejtor për Shërbime Publike dhe Mjedis, Durim Hajra - Drejtor i Inspektoriatit, Mirsad Qyqalla - Drejtor i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ylber Kelmendi - Drejtor i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Arianit Tërmlkolli - Drejtor për Infrastrukturë, Taulant Kelmendi - Drejtor për Planifikim Urban, Adriatik Zeqiri - Drejtor i Arsimit.

Të tjerë: Përfaqësues të Shoqërisë Civile.

REND DITE

1. Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës e datës 28.04.2026.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Propozim për shqyrtimin e lirimit nga pagesa e taksës për legalizmin e objekteve individuale për banim për gratë dhe personat më nevojë të vecanta.
4. Propozim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Spitalit Hospice dhe harmonizimin me dokumentet planifikuese.
5. Propozim për fillimin e procedurës për shqyrtimin e iniciativës së përbashkët me Komunën e Obiliqit për organizimin dhe fuqizimin e kujdesit dytësor shëndetësorë.
6. Shqyrtimi i dytë i Projekt - Rregullores për taksa komunale.
7. Shqyrtimi i dytë i Projekt - Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike.
8. Shqyrtimi i dytë i Projekt - Rregullores për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë-Kosovës.
9. Shqyrtimi i dytë i Projekt - Rregullores për organizimin e bashkëpunimit të komunës me lagjet urbane dhe fshatrat në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

10. Shqyrtimi i dytë i Projekt - Planit Lokal të Veprimet për Barazi Gjinore në Komunën e Fushë Kosovës për vitet 2026 - 2028.
11. Shqyrtimi i parë i Projekt - Rregullores për lëshimin e lejes për instalimin e paneleve fotovoltaike.
12. Shqyrtimi i parë i Projekt-Planit Lokal të Veprimit për avansimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2026-2029.
13. Propozim për shqyrtimin e Kërkesave të Shoqatave të Veteranëve dhe Invalidëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Nr. 01-104/02-0005477/26 dhe Nr. 01-104/02-0003204/26 për lejimin e mjeteve financiare.
14. Rishqyrtimi i vendimit Nr. 65, të datës 24.02.2026, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë Kosovë.
15. Shqyrtimi i Kërkesës Nr. 02-070/05-0015252/26 të datës 25.05.2026, për lejimin e ndihmës financiare për Shoqatën e Kosovës për Kërkim-Shpëtim.
16. Propozim për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Projekt-Planin Komunal për Gjithëpërfshirje Sociale.
17. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndetje të nderuar të pranishëm anëtarë të Kuvendit të Komunës, musafirë mirë se po takohemi në mbledhjen e pestë të Kuvendit të Komunës të Fushë-Kosovës, po e hapim zyrtarisht mbledhjen, po filloj me leximin e pikave të rendit të ditës dhe rekomandimet që kanë ardhur nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, pika e parë e rendit të ditës është: Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës e datës 28.04.2026, pika e dytë Pyetje dhe përgjigje parlamentare, pika e tretë Propozim për shqyrtimin e lirit nga pagesa e taksës për legalizmin e objekteve individuale për banim për gratë dhe personat më nevojë të vecanta, pika e katërt Propozim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Spitalit Hospice dhe harmonizimin me dokumentet planifikuese, pika e pestë Propozim për fillimin e procedurës për shqyrtimin e iniciativës së përbashkët me Komunën e Obiliqit për organizimin dhe fuqizimin e kujdesit dytësor shëndetësorë, pika e gjashtë Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për taksa komunale, pika e shtatë Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike, pika e tetë Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë-Kosovës, pika e nëntë Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për organizmin e bashkëpunimit të komunës me lagjet urbane dhe fshatrat në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, pika e dhjetë Shqyrtimi i dytë i Projekt-Planit Lokal të Veprimet për Barazi Gjinore në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2026-2028, pika e njëmbëdhjetë Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores për lëshimin e lejes për instalimin e paneleve fotovoltaike, pika e dymbëdhjetë Shqyrtimi i parë i Projekt-Planit Lokal të Veprimit për avansimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2026-2029, pika e trembëdhjetë Propozim për shqyrtimin e Kërkesave të Shoqatave të Veteranëve dhe Invalidëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Nr. 01-104/02-0005477/26 dhe Nr. 01-

104/02-0003204/26 për lejimin e mjeteve financiare, pika e katërmëdhjetë Rishqyrtimi i vendimit Nr. 65, të datës 24.02.2026, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë dhe pika e pesëmbëdhjetë Të ndryshme: Rekomandim i Komitetit për Politikë dhe Financa, është që pika e pestë e rendit të ditës të tërhiqet dhe të merret vendim në mbledhjen e radhës kur të gjitha procedurat lidhur me këtë propozim të jenë të plotësuara. Pikat shtesë të rekomandura nga Komiteti për Politikë e Financa janë: Shqyrtimi i kërkesës Nr. 020-7005-0015252/26 të datës 25.05.2026, për ndihmë financiare të Shoqatës së Kosovës për Kërkim-Shpëtim dhe Propozimi për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Planin Komunal për Gjithpërfshirje Sociale. Pra i kemi tri rekomandime nga Komiteti për Politikë dhe Financa, njëri rekomandim është të tërhiqet një pikë dhe të shtohen dy pika tjera. Unë po e hap diskutimin, nga Lëvizja Vetëvendosje Kosovar Ademi fjala për ju.

Kosovar Ademi: Përshëndetje kolegë asambleistë, dje në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa jemi të njoftuar, që kanë pranuar kritika për Rregulloret nga opozita, e cila ka konsideruar që ka mangësi në projektim të rregulloreve, edhe ne konsiderojmë që ndoshta ka ndonjë mangësi ose duhet të lejohet një hapësirë të shtohen dhe përmirësohen disa gjëra. Nëse opozita konsideron që duhet të shtyhen këto katër si pika të rendit të ditës, ne e përkrahim.

Laureat Gojnovci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje, faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, të nderuar drejtor, anëtarë të Kuvendit të Komunës dhe pjesëmarrës tjerë në mbledhje. Sa i përket pikave të rendit të ditës, ne kemi kërkuar dje në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, që rregulloret të trajtohen në mbledhjen e ardhshme, sepse kemi konsideruar që nuk janë të planifikuara mirë dhe mënyra, si ka ardhur deri tek përpilimi i këtyre rregulloreve lënë shumë për të dëshiruar, jemi ndier të injoruar nga Ekzekutivi i Komunës, në hartimin e këtyre rregulloreve, ku grupet punuese kanë pasur vetëm një takim në komunë, është mbajtur një punëtori nga Ekzekutivi i Komunës në Shqipëri, pa hartuesit kryesor nga Kuvendi i Komunës. Materiali ka ardhur ditën e martë, dëgjimet publike janë mbajtur ditën e merkur dhe të enjte dhe Grupi Punues nuk ka mbajtur takim për të marrë komentet e qytetarëve, projektet finale nuk kanë asnjë ndryshim prej asaj që ka ardhur ditën e martë. Ne jemi për t'i votuar rregulloret dhe të kontribuojmë në përpilimin e tyre, por nuk na është dhënë mundësia, asnjëra nga pikat shtesë që kanë ardhur për shqyrtim, nuk janë urgjente që të trajtohen në këtë mbledhje, ne do të votojmë që t'i ndihmojmë Shoqatës për Kërkim-Shpëtim, por vetëm nëse vjen si pikë e rendit të ditës mbledhjen e ardhshme, ndërsa pika tjetër për formimin e këtij Grupi Punues, unë e di që këto Grupe Punuese formohen në Kuvendin e Komunës dhe sot ka ardhur pikë shtesë ku shkruan vendim edhe nga Kryetari i Komunës i ka vendosur këtu 19 emëra. Nëse largohen nga rendi i ditës rregulloret së bashku me dy pikat shtesë e keni votën tonë, nëse jo nuk i votojmë.

Migjen Kolshi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, sa i përket pikave shtesë të rendit të ditës, është bërë një praktikë jo e mirë që çdo mbledhje të kemi pika shtesë, këto pika nuk janë urgjente dhe ne nuk i përkrahim. Sa i përket rregulloreve, asnjëherë rregulloret nuk është bërë pa jurist, ne si Grup Punues në rregulloren që kemi punuar nuk kemi pasur jurist, për derisa nuk merret një vendim, që të punohen nga fillimi këto rregullore ne nuk i përkrahim.

Ali Ismaili: Përshëndes të pranishmit në mbledhje, tani i përshëndes drejtorët që janë prezente dhe Kryetarin e Nënkryetarin që nuk janë sepse neve na kritikojshin në të kaluarën. Brenda katër viteve kemi mbajtur 44 mbledhje dhe në asnjë mbledhje Lëvizja Vetëvendosje nuk ka votuar pikat shtesë, sepse është bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, që nëse nuk janë urgjente nuk duhet votuar, tani jemi në mbledhjen e pestë dhe vazhdimisht po sjellin pika shtesë për të cilat, nuk e di kur do të ndaleni dhe jam kundër. Sa i përket rendit të ditës, unë kam vërejtje sidomos te pika e pestë, sepse kujdesi dytësorë e tretësorë shëndetësorë, nuk është në kompetencën e Kuvendit të Komunës, kjo ka të bëjë me nivelin qendror dhe mendoj që është gabim, kjo pikë e rendit të ditës. Tek rregulloret mirë që po tërhiqen, sepse kam pasur vërejtje edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa, vërejtja ime ka qenë e bazuar në Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me Nr. 06/2018, çdo rregullore duhet të kalojë dëgjimin publik prej 15 ditëve, kështu që e keni shkelë këtë Udhëzim, i keni zgjedhë Kryesuesit e Grupeve Punuese dhe është mirë Kryesuesi i Grupit të na dërgoj në email propozimet që kur nuk jemi prezentë të jemi të informuar për ecurinë e rregulloreve, si dhe është mirë të mbahen procesverbale në punëtori. Kryesuesi e ka bërë një thirrje publike dhe do të ishte mirë të përfshihen Kryesuesit e Grupeve Punuese, që janë edhe asambleistë dhe do të ishte mirë të mblidhet edhe njëherë Grupi Punues, pas dëgjimit publik ta shqyrtoj Rregulloren dhe në fund të vendos. Drejtori i Urbanizmit qenka prezentë, dua t'i them se jam kundër pikës së pestë, edhe pse është mirë të bëhet ky spital, por është qasje e gabueshme të interferohet në Plan Zhvillimor Komunal, sepse na kthen Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ndërsa sa i përket Organizatave Jo Qeveritare, duhet t'i ndihmojmë por jo si pushtetet e kaluara, në kohë fushate, mendoj se nuk ka ndryshuar asgjë përveç emërave.

Driton Ademi: Përshëndetje për të gjithë, sa i përket rregulloreve unë e kam shpjeguar procedurën, e cila nuk është përfillur. Kryetari i Komunës e cakton personin përgjegjës për hartimin e rregullores përkatëse, ai person përgjegjës e ka për obligim të konsultojë ekspertizën brenda Ekzekutivit të Komunës, duke përfshirë të gjitha shërbimet që janë të përbashkëta, duke filluar prej IT-së, prej financave, prej barazisë gjinore, auditimit, e tjera, pastaj vjen projekti fillestar, i kalon komisionit i cili e vazhdon aktivitetin e tij. Pas leximit të parë, mbahet diskutimi publik në afat kohor prej 15 ditësh, del shpallja publike, komisioni i merr parasysh komentet, ndoshta me diçka nuk pajtohet dhe kam kërkuar që kjo pjesa ku nuk pajtohet komisioni, të na vijë neve në Kuvendin e Komunës në formën të një procesverbali, nëse nuk është pajtuar komisioni, mund të pajtohet Kuvendi. Unë e aprovoi shtyrjen e rregulloreve, por duhet të jepet një epilog, cilat janë aktivitetet paraprake për këtë shtyrje? Duhet të mbahet procesverbal sepse është procedurë dhe komentet e qytetarëve të vijnë të shqyrtohen në Kuvend, tani pas shqyrtimit Kuvendi jep qasjen e duhur dhe formohet një rregullore që nuk i'a cenon të drejtën askujt. Ndërsa për pikën shtesë për ndihmë financiare ndaj Shoqatës së Kërkim-Shpëtim, ka rregullore në nivel të Republikës së Kosovës, që merret me procedurën e financimit të Organizatave Jo Qeveritare dhe duhet ta respektojmë këtë rregullore. Por kërkesa zyrtare është për përkrahje për financim, ndërsa në material është me një lloj 'Memorandumi mes Shoqatës dhe Komunës. Ju lutem të jeni të qartë,

për sa i përket kësaj pike të rendit të ditës: a po duam përkrahje financiare apo 'Memorandum Bashkëpunimi me këtë shoqatë.

Kosovar Ademi: Nga cili do subjekt politikë do të pranoja kritika për rregulloret përveç Lidhjes Demokratike të Kosoavës, sepse dihet që rregullorja e tyre e fundit është në vitin 2013, ka edhe më të vjetra, dësikutimet publike në atë kohë kanë qenë artificiale dhe me staf komunal. Në historinë e Komunës së Fushë-Kosovës, nuk ka pasur pjesëmarrje masovike të qytetarëve sikur në këtë rregullore dhe ne i kemi marrë parasysh komentet dhe vërejtjet e qytetarëve.

Laureat Gojnovci: Faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, ne po flasim për një realitet që po ndodh, ndonjëherë është më mirë të mos bëhen fare rregulloret, se sa të bëhen me shkelje. E përmendi kolegu pjesëmarrjen masive të qytetarëve dhe deri diku pajtohem, por a janë marrë parasysh kërkesat e qytetarëve, diskutimi publik ka ndodhë ditën e mërkure, ndërsa projekti final ka ardhur ditën e martë, kur i keni inkorporuar komentet e qytetarëve?

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit z. Laureat Gojnovci, besoj që nuk ka nevojë të sqarohet shumë procedura dhe kronologjia e fillimit të procedurave për hartimin e rregulloreve, u përmend që është bërë një injorim, sa i përket përfshirjes së anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe nuk pajtohem me atë konstatim, sepse janë përfshirë të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës nëpër të gjitha rregulloret, është caktuar një datë, një vend i Grupit Punues për hartimin e rregulloreve dhe kanë ardhur projektet e para. Projektet e para janë pjesa fillestare e tyre, e që Grupet Punuese japin kontributin e tyre, normalisht që marrin modele të ndryshme dhe tentojnë, që modelin më të mirë ta hartojmë ne si komunë. Janë mbajtur ato Grupe Punuese, ku secili ka dhënë kontributin e tij, pastaj janë mbajtur diskutimet publike dhe brenda rregullave sot munden të aprovohen, por ne jemi për të i'u dhënë më shumë kohë, nëse dikush dëshiron të shtojë apo të ndyshoj diçka, sepse të gjithë duam që këto rregullore të hartohen sa më mirë të jetë e mundur. Sa i përket Shoqatës për Kërkim-Shpëtim nuk ka të bëjë fare me politikë, veprimtaria dhe aktiviteti i kësaj Shoqatës është tërësisht human, çdo aktivitet i tyre bëhet në baza humane, na kanë ndihmuar në momentet më të vështira në kohën e vërshimeve dhe ata e meritojnë, që ne si institucion t'i mbështesim, sepse punën e bëjnë në mënyrë vullnetare. Diçka tjetër që u përmend është pika e pestë por kjo pikë po largohet nga rendi i ditës, me të drejtë e cituat që kujdesi parësor dhe kujdesi dytësor e tretësor janë të ndarë, por këtu kemi të bëjmë me një lokacion i cili është në bashkëpunim mes të dy komunave, kur ka raste të tillë, atëherë duhet patjetër të trajtohet në Kuvendin e Komunës, ndërsa menaxhimi është nga niveli qendror. Për arsye të disa procedurave po e tërheqim si pikë në këtë mbledhje dhe do e trajtojmë në mbledhjen e ardhshme.

Ali Ismaili: Kryesues i Kuvendit të Komunës, më fal që po të ndërpres, në bazë të materialit që na ka ardhur, po flasim për një fuqizim mes dy komunave që ka të bëjë me nivelin dytësor dhe ajo nuk na takon neve por nivelit qendror.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Të gjitha menaxhohen brenda një ombrelle por janë të ndara kompetencat, për këtë arsye quhet bashkëpunim. Sa i përket asaj që tha z. Driton Ademi, pajtohem me të që tha se dallon 'Memorandumi prej mbështetjes financiare' dhe këtu kemi të bëjmë me mbështetje financiare.

Ali Ismaili: Para 10 viteve u'a kam tërheqë paralelen Ekzekutivit të Komunës për çështjen e Projektit të Karitasit, i kam thënë: Ju lutem, mos e merrni kështu lehtë, e kemi filluar Projektin e Karitasit me një qind mijë euro, kemi përfunduar me një milion e dy qind mijë euro. Kam thënë fuqizoni kapacitetet shtetërore. Bazuar në këto, sa i përket asaj ndihmës që doni me dhënë, e keni Rregulloren e Punës së Kuvendit, e keni Statutin e Komunës, është mirë të themelohet Drejtoria e Emergjencave. Nuk ka të keqe, por po e tërheqi këtë paralele, se fillojmë me dhjetë mijë euro, e përfundojmë me memorandume. E treta, këtë fletën që e ke para veti, me qëllim që me i'a mbështetë në pikën e rendit të ditës, si vendim apo propozim e keni përfshirë Lidhjen Demokratike të Kosoavës, Partinë Demokratike të Kosovës dhe anëtarët e Komuniteteve jo shumicë, e keni anashkuar Zërin e Drejtësisë, Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nismën Socialdemokratke. Propozoj që Kuvendi i Komunës të jetë sa më unik, ta futni edhe një anëtar të këtyre përfaqësuesve me qëllim që të na përfshini të gjithëve.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë, konstatohet se ka përfunduar diskutimi, po e qesim në votim tërheqjen e pikës së pestë të rendit të ditës.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e tetë anëtarë.

Tani po e qesim në votim, edhe tërheqjen e pikave gjashtë, shtatë, tetë dhe nëntë, të cilat shtyhen për mbledhjen e ardhshme.

U votua me: nëntëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe nëntë abstenime.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoj se shqyrtimi i dytë i katër Rregulloreve shtyhen për mbledhjen e ardhshme.

Tani pika tjetër që kanë ardhur si rekomandim nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, është 'Propozimi për mbështetja financiare për Shoqatën për Kërkim-Shpëtim, në shumën e mjeteve financiare prej: 9,500.00€.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', njëmbëdhjetë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoj që kjo pikë aprovohet dhe hyn për shqyrtim në rendin e ditës.

Pika tjetër shtesë është caktimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Planin Komunal për Gjithëpërfshirjen Sociale.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', nëntë vota 'kundër' dhe tre abstenime.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoj që pika në fjalë hyn për shqyrtim në rendin e ditës edhe kjo pike me shumicë të votave.

Tani pas largimit nga rendi i ditës të pikave: pesë, gjashtë, shtatë, tetë dhe nëntë dhe aprovimin për shqyrtim të dy pikave shtesë si rekomandime nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e qesim në votim rendin e ditës në tërësi me largimin nga shqyrtimi të pesë pikave të cekura më lartë dhe shqyrtimin e dy pikave shtesë të aprovuara me shumicë të votave për shqyrtim.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe njëmbëdhjetë abstenime.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoj që aprovohet rendi i ditës me tërheqjen nga shqyrtimi të pesë pikave të cekura më lartë dhe aprovimin e dy pikave shtesë për shqyrtim.

Pika e parë (1) - Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës e datës 28.04.2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi për shqyrtim për vërejtjet apo sugjerimet tuaja 'Ekstraktin e Procesverbalit të mbledhjes së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës e mbajtur me datën 28.04.2026'. Hap diskutimin.

Kosovar Ademi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim për aprovimin 'Ekstraktin e Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datën 28.04.2026, meqë përpilimi i tij, është në përputhje me atë që kemi diskutuar në mbledhjen paraprake.

Laureat Gojnovci: Faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, janë dy arsye pse nuk e votojmë këtë ekstrakt të procesverbalit. E para, sepse po shkelet Ligji për Vetëqeverisje Lokale. Ka pasur filluar një praktikë e mirë që ka ndodhur në të kaluarën, për të cilën e kam përgëzuar personalisht që dikush ka ardhur dhe i ka transmetuar mbledhjet e Kuvendit të Komunës, po tani e tutje nuk po bëhet më, arsyet i dijnë këta. E dyta, pse nuk e votojmë gjithë një sipas dëshmitarëve, gjuha e përdorur nga Kryetari i Komunës z. Valon Prebreza, është zbutur, është bërë pambuk në ekstraktin e procesverbalit.

Valon Murseli: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Mendoj që është shkelur Rregullorja e Punës së Kuvendit të Komunës, neni 16, paragrafi 1 dhe paragrafi 3, në rastin e audio-incizimit, mbledhja e Kuvendit të Komunës duhet të publikohet në faqen elektronike të komunës, çka nuk ka ndodhur, andaj kemi kundërshtim në këtë pikë.

Migjen Kolshi: Kryesues i Kuvendit të Komunës, te pika e katërt emri i rruges në fshatin Harilac, që e kam përmend nuk ka qenë 'Antena', por 'Atava', kjo duhet të përmirësohet.

Ali Ismaili: Unë kam vërejtje për këtë ekstrakt të procesverbalit, prej 43 faqeve, shumë pjesë më keni nxjerrë nga tema, shumë pjesë e keni zbukuruar e shumë pjesë nuk jam unë fare. Kërkoj të merret parasysh vërejtja ime.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani po e qesim në votim për aprovim 'Ekstraktin e Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datën 28.04.2026', me përmirësimet nga të gjitha vërejtjet e paraqitura.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', dymbëdhjetë vota 'kundër' dhe një abstenim.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstaton se aprovohet 'Ekstrakti i Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datën 28.04.2026', me përmirësimin e tij.

Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi pikën 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të parashtrijnë pyetjet e tyre për Ekzekutivin e Komunës.

Laureat Gojnovci: Faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, dua të filloj me një kërkesë që në këtë Kuvendin e Komunës, të mbizotëron një debat i mirëfilltë, sepse dje në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, jemi dëshmitar ne anëtarët e tij, për një sjellje arrogante të Drejtorit për Shërbime Publike dhe Mjedis z. Izja Mjeku, të cilin është detyruar një koleg i tij, ta

largoj nga zyra dhe në dy pikat e fundit, e kam lëshuar mbedhjen unë edhe pse nuk ishte në raport me mua. Ne si Grup Parlamentarë i Lidhjes Demokratike të Kosoavës, kërkojmë të respektohem si ju respektojmë. E kam një pyetje për Drejtoreshën e Administratës, a është e vërtetë që në trajnimet që bëhen nga Ministria dhe Organizata të ndryshme, dërgohen punëtorët që janë me projekt, sepse ligjërisht nuk kanë të drejtë. Tani këtu Kryetari i Komunës dhe Nënkryetari i Komunës, nuk qenkan prezentë në mbledhje sot, unë kam pyetje për ta, përgjegjësi kryesor për zhvillimin e politikave të komunës është Kryetari i Komunës, bashkë me drejtorët e tij dhe në faqen e E-Prokurimi është 0 projekte, pra nuk është duke u zhvilluar asnjë projekt kapital. Krejt projektet që janë duke u zhvilluar janë të pushtetit të kaluar. Po flas tani për ujin në fshatin Lismir, sepse u lëshua çeshmja në kohën e zgjedhjeve locale, por për dy javë nuk ka ujë, as nga Kuzmin për nevoja elementare jetësore, komuna nuk është përgjegjëse, por së paku duhet të interesohet. Drejtorja a ju ka lejuar Kryetari i Komunës, të merrni automjete zyrtare në shtëpi jashtë orarit të punës edhe ditëve të vikendeve? Në debatin në KTV, vetë Kryetari i Komunës ka thënë se Ekzekutivi i kaluar, ka shpenzuar 600,000.00€, për derivate në fushatën e kaluar, tani ta nxjerrë ai raportin për këto shpenzime dhe unë do të dal publikisht me të në video dhe do të kërkoj falje, por nëse nuk është e vërtetë, duhet ai ta pranoj publikisht. Subvencionet në Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport, tani Udhëzimi Administrativ, kërkon me pas një ekspert të jashtëm dhe në këtë Komision nuk ka ekspert të jashtëm, për të ndarë subvencionet në Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit? A është e vërtetë që Klubi Futbollistik 'Fushë-Kosova', nuk ka marrë asgjë prej këtij subvencioni? Për Drejtorinë e Drejtorisë së Arsimit deri ku kanë shkuar punimet në 'Çerdhen modulare' dhe deri ku ka arritur procesi i ndarjes së bursave? Këto janë kërkesat që pata unë për t'i adresuar sot, shpresoj të marrë përgjigje.

Migjen Kolshi: Faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, kam pyetje për Drejtoreshën e Administratës punëtorët me projekte të 'Karitasit dhe Kosova Medit', a janë të pajisur me kartela të punës që kur vijnë në punë lajmërohen ose jo. Për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, çfarë është duke ndodhur me Stadiumin e Futbollit, a ka filluar auditimi i projektit dhe pse nuk po vazhdon ai projekt, pyetja tjetër, a është politike mosdhënia e ndihmës financiare për Klubin Futbollistik 'Fushë-Kosova', kur shumicës së klubeve në Komunën e Fushë-Kosovës, ju janë dhënë mjetet financiare? Kryetarin e Komunës, nuk po e shoh prezent, e kam pyetur në mbledhjen e dytë, se pse nuk e keni ndërprerë kontratën në Arsimit për të punësuar punëtorët? Ka thënë se në Arsimit nuk ka mundur për arsye se të gjithë punëtorët e kanë nënshkruar kontratën. Atëherë, pse nuk u ekzekutohet pagat atyre? Nëse ka parregullsi, pse nuk e anulon atë konkurs. Pasi që në muajin qershor është në shqyrtim 'Korniza Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029', dua të lidhem me fshatin Harilaç janë disa kërkesa që duhet të futen në procesverbal si vijon: Kërkesa për renovimin e shkollës në fshatin Harilaç, kërkesë për fushë të futbollit si dhe një kërkesë që është me mbi 150 nënshkrime për rrugën 'Atava'.

Ali Ismaili: Unë sot në mengjes 12 pyetje i kam deponuar me shkrim dhe po shpresoj të marrë përgjigjet me shkrim, sepse tani e tutje do t'i publikoj, kanë të bëjnë me z. Durim Hajra - Drejtorinë e Inspektoratit, Drejtoreshën e Administratës, një që nuk i'a kam adresuar, po ua adresoj sot, ajo

është ai kontrollon punëtorët me Projektin e Karitasit, a nënshkruajnë dikun ata kur hyjnë dhe dalin nga puna.

Aida Alimi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Së pari dua të ju uroj festën e Kurban Bajramit të gjithë besimtarëve myslimanë. Pyetja ime ishte për Kryesuesin e Kuvendit të Komunës kur do të jenë funksionalë mikrofonat në sallën e Kuvendit të Komunës, kërkoj nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, që të merret seriozisht me këtë çështje, që të rregullohen mikrofonat. Një pyetje për Drejtorin e Inspektoriatit, lirimi i hapësirave publike dhe e kisha lutur që sa më shumë të inspektoj lokalet në Fushë-Kosovë, sepse po ndodhin shumë dukuri negative dhe është kërkesë e qytetarëve. Po ashtu, kërkoj nga kjo foltore që të gjitha gratë ta mbështesin pikën e tretë të rendit të ditës, e cila u takon direkt grave: Propozimi për shqyrtimin dhe lirin nga pagesa për taksat e legalizimit të objekteve individuale për banim për gratë dhe personat me nevoja të veçanta. Një kërkesë tjetër për Kryesuesin e Kuvendit të Komunës, janë edhe 'Kartat e identifikimit për të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës'. Është mirë me u pajisur me karta dhe të mund të identifikohemi zyrtarisht që jemi anëtarë të Kuvendit të Komunës, po më vjen mirë që pika e rendit të ditës për rregulloret është shtyrë për mbledhjen e ardhshme, po ashtu kërkoj që diskutimet publike të bëhen edhe në zonat rurale, të ngrihen çështjet dhe të merren parasysh diskutimet, nevojat dhe kërkesat e atyre qytetarëve. Po ashtu, dua të dijë deri ku kanë arritur punimet dhe a kanë filluar punimet e 'Komisionit për emërimin e rrugëve', ka kërkesa imediate që rrugët të emërohen, sepse njerëzit kanë mbetur pa adresa.

Ali Topalli: Përshëndetje të nderuar kolegë dhe të pranishëm në mbledhje. Për Ekzekutivin e Komunës i kam tri pyetje, është një pyetje e përgjithësuar për investimet e planifikuara që kanë qenë më herët. E para është për Stadiumin e Qytetit, janë mjetet financiare në shumë prej 215,000.00€, që kanë qenë të planifikuara, deri ku kanë arritur procedurat, a është bërë ndonjë punë konkrete? Tani shuma prej: 215,000.00€ janë investime në Stadiumin e Qytetit, shuma prej: 700,000.00€ është për Qendrën Multifunkionale dhe shuma prej: 300,000.00€ është për renovimin e fushave me bari sintetikë. Janë mjete financiare të planifikuara, unë desha të pyes vetëm, a kanë filluar ndonjë procedurë pas gjashtë muajve, apo jeni ende në pritje.

Valon Murseli: Një kërkesë që kam bërë prej datës 24 prill, për qasje në dokumente publike rreth automjeteve, është tejkalluar afati prej 30 ditëve dhe nuk kam marrë asnjë përgjigje. Për këtë i jam drejtuar Agjencisë për Informim dhe Privatësi dhe besoj që do të më mundësojnë këto të dhëna. Një pyetje për Drejtoreshën e Administratës është, a ka automjete me tabela private të cilat shfrytëzohen nga zyrtarët komunalë, nëse ka, pse ndodh kjo punë? Gjatë muajit Prill kemi parë shpenzime për 'Udhëtime jashtë vendit', në shumën e mjeteve financiare prej rreth 14 mijë eurove, prej tyre 6 mijë euro për udhëtimin në Shqipëri për rregullore. Po ashtu, 10 mijë euro janë shpenzuar për Zyrat e Kryetarit të Komunës, në kohën kur ka inflacion dhe qytetarët përballen me probleme elementare, mendoj që është shumë. Pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Infrastrukturës, në planin buxhetor, rruga 'Tahir Zemaj' ishte paraparë një investim prej: 200,000.00€ për asfaltim, gjendja e saj është shumë e keqe. Nëse është larguar, pse është larguar pasi në planin e prokurimit nuk është. Po ashtu, projekti për renovim të objekteve në rrugën 'Bedri Pejani', në planin e prokurimit ka mbetur si rezerve, nëse mund të më jepni përgjigje, pse? Tani e pesë muaj kam bërë

kërkesë për lirim e disa hapësirave publike, asnjë veprim nga Drejtoria e Inspektoratit. Nëse jeni të sinqertë që nuk guxoni me i liruar këto hapësira, sepse disa njerëz të fuqishëm janë duke i shfrytëzuar ato hapësira publike në rrugën '28 Nëntori' dhe në rrugën 'Besa-Besa', kërkoj të shikohet ligjëshmëria e objekteve që janë në këtë zonë. Për Drejtorin e Drejtorisë së Infrastrukturës, në rrugën në kryqëzimin e fshatit Henc, qytetarët kërkojnë që të vendosen shenjat e tonazhit, për arsye se po kalojnë kamionë me ngarkesa shumë të larta. Për Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, fëmijët të cilët kanë një largësi afër dy kilometra nga shkollat 'Mihal Grameno', aneksi 1 dhe 3, për arsye të largësisë dhe mbingarkesës, këta fëmijë shkollimin e tyre e kalojnë në katër ndërrime, gjë që paraqet problem për shumë prindër. A mund të përfshihet në Rregulloren për subvencione ky ndryshim, sepse ai ka thënë që do të ndryshohet legjislacioni dhe të paraqiten mjete financiare në planin e buxhetit për vitin 2027. Pyetje për Drejtoreshën e Administratës, është se sa punëtorë i kanë gjetur me projektin e Karitasit kur keni ardhur në pushtet dhe sa punëtorë janë punësuar përmes Projektit të Kosova Med? Kam pyetje edhe për Kryetarin e Komunës, por meqenëse nuk është i pranishëm po ua dorëzoj këtë letër juve.

Etnik Berjani: Përsëritet kolegj dhe të gjithë të pranishëm në mbledhje, kam disa pyetje për Kryetarin e Komunës dhe Kryesuesin e Kuvendit të Komunës, së pari për punëtorët e 'Kosova Med-it dhe Karitasi-it', ka prej tyre që paguhet dhe nuk paraqiten fare në punë, i kam identifikuar dhjetë raste të tilla. Është një kërkesë nga banorët e fshatit Miradi e Epërme, po kërkojnë disa ulëse të shëtitortja që është prej Xhamisë së fshatit deri të rruga kryesore. Në qoftë se ka mundësi, ato ulëse të vendosen, sepse ka njerëz të moshuar që ecin dhe kanë nevojë të pushojnë. Mikrofonat ku janë, në qoftë se ka nevojë po e financojmë atë privatisht si donacion, sepse nuk është kjo ndonjë gjë e madhe me i vendos disa mikrofona nëpër ulëse, gjë që ua bën pak më të lehtë edhe kolegëve me marrë fjalën më lehtë, e më shpejt. Projektet që po mundoheni t'i përvetësoni, si për shembull të rruga 'Mumin Gashi' në Fushë-Kosovë, e keni paraqitur si projekt tuajin, kur është projekt i qeverisjes të kaluar, vazhdoni e bëni projekte të reja. E keni mbushur komunën me punëtorë, çdo të dytin apo të tretin që takoj, po thotë: jam këshilltar i Shpendit. Shpendi e dijmë që është shumë i aftë, s'ka nevojë për të gjithë ata këshilltarë. Nuk e di a mund të na tregoni se sa këshilltarë i ka dhe a ka të drejtë me patur këshilltarë? Kështu që i kam bërë disa pyetje tani, kurse Kryetarit të Komunës, i'a kam dërguar edhe një email, një kërkesë, sepse në mbledhjen e kaluar nuk ishte këtu, nuk po kthen përgjigje. Kryetari i Komunës ka dalur në media me 62 dosje për gjetje të parregullsive, sipas informatave që unë i kam, ato dosje i'u kanë kthyer me email si të pa bazuara. Ka bërë kopje të dokumenteve, i ka dërguar për verifikim si gjetje, por institucioni ku i ka dërguar nuk bënë verifikime të tilla, ata në qoftë se gjejnë shkelje, e vazhdojnë procedurën vetë. Për Kompaninë e Pastrimit, unë si aksionar jam interesuar, sepse tha se kam informata që po punojnë me dy lloj dokumentesh, por nuk e di saktë. Në qoftë se mendon që ka shkelje, t'i dërgojnë në prokurori, se ato na bëjnë dëm edhe neve, jo veç Lëvizjes Vetëvendosje. Në qoftë se shih parregullsi, duhet të na ftojë në takim.

Jetmir Berisha: Përsëritet Kryesues i Kuvendit të Komunës, të nderuar kolegj, drejtorë dhe të gjithë të pranishëm. Unë i kam disa pyetje, deri ku ka arritur projekti për rrugën Bardhi i Madh - Graboc i Poshtëm, që është rruga më e dëmtuar në Kosovë? Tek shkolla 'Laura Scotti', në fshatin

Graboc i Poshtëm, janë disa pengesa të vogla, por kërkoj të vendosen dy pengesa të mëdha për arsye të lëvizshmërisë së fëmijëve dhe ngasjes së shpejtë e të pakontrolluar të automjeteve. Pyetja e tretë është kam kërkuar që transporti publik të mos subvencionohet në llogari të prindërve, por të kthehet sikurse ka qenë më herët, që fëmijët t'i marrë kombibusi apo ndonjë kompani e cila i merr në rregull dhe i kthen në rregull dhe me kohë fëmijët. Ngarkesa dhe nevoja e prindërve për të punuar është problematike, sepse po mundohen të dy prindërit të punojnë, prandaj kishte me qenë shumë e rëndësishme që të aktivizohet përsëri siç ka qenë më herët. Pyetja tjetër është rruga 'Berisha', që lidhet me rrugën 'Topi', është fjala për lagjen Zogjani, fëmijët e tyre rrezikohen kur vijnë në shkollë, sepse e kanë daljen direkt në rrugën kryesore. Kemi mundësi të lidhemi nga afër lumit poshtë, që na shpie deri te ura ose vigu, që është punuar në mandatin e fundit para katër viteve dhe të bëhet një trotuar për ata fëmijë, që të vijnë deri para hyrjes së shkollës, në mënyrë që rreziku për ta në komunikacion të jetë minimal. Në cilin ligj apo udhëzim administrativ jeni bazuar për të kërkuar pasqyrat financiare të tri viteve të fundit për të gjitha Organizatat Jo Qeveritare, për të aplikuar e për të fituar të drejtën apo përfitimet që u takojnë, sepse unë mendoj që këtë kontroll, nuk ka të drejtë ta bëjë as komuna, as drejtoria, por janë organet e tjera si Administrata Tatimore e Kosovës dhe Inspektorati. Për arsye të këtij kriteri janë penalizuar disa Organizata Jo Qeveritare dhe s'kanë pasur të drejtë përfitimi. Komuna është dashur vetëm të kërkojë dokumentacionin ose arsyetimet e shpenzimeve për ndihmat që u ka bërë Organizatave Jo Qeveritare në tri vitet e fundit, sepse këtë ka të drejtë ligjore ta shoh se ku kanë shkuar ato mjete financiare.

Rrahim Tërnavë: Investimet që janë bërë në fshatin Sllatinë e Vogël për fushën sportive, çfarë ka ndodhur me rrymën atje, pse nuk është funksionalizuar ajo fushë dhe pse operatori po bën ankesa? Është një Palestër e mirë, shumë e nevojshme, kanë kaluar vite dhe ajo fushë ende nuk po rregullohet. Kam edhe pyetje të tjera për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, çfarë është duke ndodhur me impiantin në fshatin Lismir? Qytetarët atje janë të shqetësuar, është shumë shqetësuese kjo punë, por pa pasur përgjigje nga Drejtori dhe as nga Kryetari i Komunës këtu, si do të drejtohem? Është mirë që drejtorët të jenë më seriozë, e të na përkushtohen pak më shumë në teren.

Drejtoresha e Administratës: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Sqaroj se punëtorët e projekteve të 'Karitasit dhe Kosova Medit', nënshkruhen në listat e ardhjes dhe shkuarjes nga puna, janë të evidentuar, ndërsa për qasje në dokumente zyrtare është personi përgjegjës i caktuar nga Kryetari i Komunës, nuk jam unë e ngarkuar me këtë detyrë të punës.

Drejtori për Kulturë Rini dhe Sport: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Sa i përket anëtarëve të Komisionit të jashtëm, ka qenë edhe një anëtarë e cila ka dhënë dorëheqje, për arsye të problemeve shëndetësore dy ditë para përfundimit të çertifikimit të lëndëve. Sa i përket klubit të futbollit, komisioni është ai i cili i vendos kriteret dhe jo vetëm Klubi i Futbollit 'Fushë-Kosova', por kemi edhe shumë Organizata tjera Jo Qeveritare, të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret dhe ne do të hapim përsëri një thirrje tjetër, vetëm për t'i lehtësuar disa procedura, ndërsa sa i përket Stadiumit e kemi diskutuar herën e kaluar, ju kam informuar se Federata e Futbollit të Kosovës, e ka anuluar projektin e vet.

Migjen Kolshi: Nuk është e vërtetë, tani Federata e Futbollit të Kosovës, e ka bërë punën e vetë sipas rregullave dhe ligjeve të Federatës. Domethënë nuk ka ndërhyrje, ajo ka bërë punët e saj, kurse stadiumi i ka mbetur nën menaxhim komunës.

Drejtori për Kulturë Rini dhe Sport: Tani kështu Federata ka pasur një 'Marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport', e cila do të na sillte 1.8 milion euro investime dhe e ka ndërprerë, e kam me email zyrtar nga Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës z. Agim Ademi dhe mund ta dërgoj në email. Sa i përket projekteve, është projekti i planifikuar nga Ish-Drejtori i Kulturës Rinisë dhe Sportit, për pllakat përkujtimore në Fushë-Kosovë, Harilaç dhe Sllatinë të Madhe. Si ka mundësi që bëhet një pllakë përkujtimore, e cila ka një gjatësi prej 1.50 metra dhe në të do të shkruhen 168 emra? Si ka mundësi të shkruhen gjithë ata emra në një pllakë shumë të vogël? Ka ankesa nga organizatat, është paralajmëruar protesta dhe arsyetimi i Lëvizjes Nacionale Demokratike Shqiptare, si ka mundësi mos të vendoset aty. Pra, e kemi edhe kërkesën e organizatave të luftës, të cilët kanë thënë se nëse vendoset ndryshe do të bëjnë protestë, sepse ata nuk e pranojnë. Sa i përket Palestrës së Sporteve në fshatin Sllatinë e Vogël, operatori ka përfunduar punën dhe ka kryer punë shtesë në shumën e mjeteve financiare prej: 150,000.00€, pa asnjë kontratë e pa asnjë aneks-kontratë. Projekt në vlerë 2 milion euro, ku nuk është paraparë trafoja për energji elektrike. Asnjë klub nuk i shpëton ngritjeve dhe rënieve. Personalisht e kam kontaktuar Klubin e Futbollit dhe z. Samir Ujkani ka shprehur dëshirën për ta privatizuar këtë klub. Po punohet në atë aspekt që të privatizohet klubi, e të mos varet vetëm nga ndihmat dhe subvencionet e komunës, sepse duke u varur vetëm nga komunat, klubet po mbesin prapa. Duhet të marrim shembull nga qytetet e tjera si Suhareka, Malisheva, Lipjani e të tjera.

Ali Topalli: Unë jam shumë qetë, kam shumë dëshirë që edhe drejtori të vazhdojë ashtu, sepse po tenton në çdo mbledhje të më atakojë. Por unë kam shumë respekt dhe konsideratë, sepse në një moment, e kam ftuar në zyrë dhe i'a kam dorëzuar detyrën në mënyrën më të mirë të mundshme. Kështu që bëhu pak më i kujdesshëm dhe më i respektueshëm ndaj meje, sepse nuk kam asgjë personale me ty. E përmendët drejtor, çështjen e tri pllakave memoriale në Fushë-Kosovë, Harilaç dhe Sllatinë të Madhe. Kolegë të nderuar, kjo nuk është e vërtetë. E kam këtu projektin dhe nuk është vetëm në këto tri vende, te projektet e drejtorisë e gjeni saktë se ku janë planifikuar këto pllaka memoriale. E dyta, çështja e dimensioneve dhe paramasave nuk është bërë nga drejtori, ato i ka bërë një ekip profesional brenda drejtorisë, me të gjitha paramasat dhe parametrat e paraparë për këto pllaka memoriale, duke paraparë edhe hapësirën për shkrimin e 168 emrave. Kështu që këto pllaka memorial nuk janë të dimensioneve të njëjta, prandaj kërkoj të mos keqë kuptohemi, drejtor.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë, shkojmë në pauzë dhe kthemi prapë për të vazhduar mbledhjen në orën 14:00h.

Pika e tretë (3) - Propozim për shqyrtimin e liritimit nga pagesa e taksës për legalizmin e objekteve individuale për banim për gratë dhe personat më nevoja të veçanta.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Materialin e keni para vetës, besoj e keni lexuar, po e hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës me anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Kosovar Ademi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim këtë propozim, pasi që konsiderojmë që është i nevojshëm dhe lehtësues për kategoritë të cilat kanë nevojë më së shumti për mbështetje institucionale.

Laureat Gojnovci: Sa i përket këtij propozimi, ne dje e kemi votuar, qëllimi është i mirë dhe meqenëse Ekzekutivi i Komunës, e ka propozuar këtë, atëherë t'i zgjerojmë këto kategori, të jenë fëmijët e dëshmorëve, si dhe veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që të lirohen nga këto taksa dhe të legalizohen të gjitha banimet individuale gjatë kësaj periudhe. Kështu që ne e përkrahim, por propozojmë që ta hedhim propozimin tonë në votim, që të kalojnë edhe invalidët, fëmijët e dëshmorëve dhe veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Migjen Kolshi: Parimisht e përkrahim këtë pikë, por kërkojmë që të përfshihen veteranët dhe invalidët e luftës dhe e votojmë bashkarisht.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë, atëherë unë po e jap një sqarim, këto dy kategori janë përzgjedhur për t'i mbështetur specifikisht në këtë fazë. Faza aktuale është kjo të lirohen gratë dhe personat me nevoja të veçanta, ne po e marrim propozimin që ka ardhur nga Ekzekutivi i Komunës. Në mbledhjet e tjera, ne mund të marrim bashkërisht iniciative të tilla, për ta futur si pikë të rendit të ditës, si kërkesë të veçantë të Grupeve Parlamentare. Nuk ka asnjë problem, por për momentin planifikimi është bërë vetëm për këto dy kategori dhe është mbështetur në normat ligjore dhe juridike. Shkojmë me këtë propozim, pastaj në të ardhmen, unë ju premtoj se do të marrim iniciativë të përbashkët për çka do që ju duket e rëndësishme. Të mos interferojmë vetëm sa për ta zgjeruar këtë fushë tani, sepse po e përsëris, askush nuk është përjashtues, por planifikimi për momentin është bërë në këtë drejtim.

Laureat Gojnovci: Kryesues i Kuvendit të Komunës, ju jeni i obliguar ligjërisht të hedhni në votim propozimin tonë, me sa po shoh edhe Partia Demokratike e Kosovës, po pajtohet që propozimi ynë të kalojë, kështu që po ju kërkojmë ta hidhni në votim njëherë propozimin tonë, e nëse ai nuk kalon, atëherë hidhet në votim propozimi juaj.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë jam i obliguar ta hedh në votim propozimin që ka ardhur zyrtarisht. Unë e hedhi në votim propozimin që ka ardhur nga Ekzekutivi i Komunës.

Laureat Gojnovci: Jo, duhet edhe propozimin tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Të mos i shfrytëzojmë këto raste vetëm pse janë të ndjeshme. Propozimi është i qartë, i kthjellët, i shkruar në letër dhe përfshin këto dy kategori. Planifikimi është bërë për to, në të ardhmen mund të vijë një propozim për kategoritë e tjera që po i përmendni ju. Ju lutem të mos tentojmë ta keqë përdorim këtë pikë të rendit të ditës, mund të na thoni thjeshtë: E mbështesim ose nuk e mbështesim. Ne ua respektojmë vendimin, por planifikimi ka ardhur specifikisht me këto dy propozime. Në mbledhjet e tjera, vetëm bëni kërkesën dhe pa asnjë problem e sjellim si pikë të rendit të ditës dhe e mbështesim, ashtu siç e planifikoni ju, pa përjashtim për të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Laureat Gojnovci: Ne jemi për ta votuar këtë pikë, por thjeshtë po propozojmë që të zgjerohen kategoritë. E juaja është ta hedhni në votim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Po ju kuptoj, por ka ardhur një material i përgatitur për këto dy kategori, ta respektojmë këtë, ta qesim në votim, propozimin siç është. Në të ardhmen sillni një

material tjetër që juve ju duket që është i nevojshëm dhe e votojmë. Atëherë e qesim në votim materialin që ka ardhur për këto dy kategori 'Propozim për shqyrtimin e lirit nga pagesa e taksës për legalizimin e objekteve individuale për banim për gratë dhe personat me nevoja të veçanta'. U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm në mbledhje. Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovon 'Propozimin për shqyrtimin e lirit nga pagesa e taksës për legalizimin e objekteve individuale për banim për gratë dhe personat me nevoja të veçanta' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 796, të datës 15.05.2026, për lirimin e plotë nga pagesa e taksës administrative si masë afirmative për taksën e legalizimit për objektet individuale të banimit, të ndërtuara pa leje në vitet 2004-2018, në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për këto dy kategori shoqërore si vijon:
 - 1.1 Gratë pronare të objekteve individuale të banimit dhe
 - 1.2 Personat me nevoja të veçanta, pronar të objekteve individuale të banimit.
2. Qëllimi i këtij vendimi është mbështetja direkte e këtyre kategorive, fuqizimi ekonomik i grave përmes regjistrimit të pronës, si dhe lehtësimi i procedurave të integritetit dhe legalizimit të ndërtimeve pa leje për personat me nevoja të veçanta.
3. Për të realizuar këtë të drejtë, aplikuesit duhet të dorëzojnë dëshmitë zyrtare mbi pronësinë apo statusin e tyre në Drejtorinë e Pronës, Drejtorinë e Gjeodezisë e Kadastrit dhe Drejtorinë e Planifikimit Urban.

Pika e katërt (4) - Propozim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Spitalit Hospice dhe harmonizimin me dokumentet planifikuese.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani po e hapim diskutimin për pikën e katërt - Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Spitalit Hospice dhe harmonizimin me dokumentet planifikuese.

Kosovar Ademi: Caktimi i lokacionit për ndërtimin e 'Spitalit Hospice', është një projekt shumë me rëndësi humane, është për pacientët të cilët kanë trajtim mjekësor për sëmundje, që janë të pashërueshme. Qëllimi kryesor i këtij shërbimi nuk është shërimi i sëmundjes, por përmirësimi i cilësisë së jetës dhe ruajtja e dinjitetit të pacientëve në fazat e fundit të jetës së tyre. Andaj, ne si Grup Parlamentarë i Lëvizjes Vetëvendosje, jemi për dhe i ftojme të gjithë kolegët nga subjektet e tjera, ta mbështesin këtë pikë të rendit të ditës.

Laureat Gojnovci: Faleminderit, kryesues, kolegu nga Lëvizja Vetëvendosje e tha që bëhet fjalë për sëmundje të pashërueshme, ky spital nuk është një spital i zakonshëm, nuk ka të tillë në Kosovë. Parimisht është për ta përkrahur, por ekziston i njëjti problem si me Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, që e kemi ndarë lokacionin te tregu. Siç na e ka kthyer Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hëpësinor, gjasat janë maksimale që të na e kthejë prapë edhe këtë propozim, për arsye se në Hartën Zonale të Komunës, është zonë pyjore, ndërsa Plani Zhvillimor Komunal është ende në shqyrtim. Drejtori na dha informacion që të premten është dorëzuar Plani Zhvillimor Komunal në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hëpësinor për ta marrë konfirmimin dhe për të

vazhduar me hapa të mëtejshëm. Ne sot po duam të ndërhyjmë në planin zhvillimor kur nuk e kemi këtë pjesë të inkuorporuar aty. Mendoj se me qenë se nuk ka spital të tillë në Kosovë, është mirë të pritët që të hyjë në fuqi Plani Zhvillimor Komunal, të inkuorporohet kjo aty dhe të mos dalim në lajthitje që të marrim qëndrim sot, të votojmë kundër. Nëse votojmë kundër, janë dy arsye: praktika e ndarjes së ngastrave kadastrale, kur vjen propozimi duhet të ketë fletën e pronës dhe kopjen e planit, sepse në gjeo-portal mund ta gjejmë. Edhe pse ky propozim është thjeshtë një hap procedural për ta caktuar lokacionin, ndërsa si projekt, si qëllim duhet të jetë nga Kryetari i Komunës ose nga Drejtoria e Shëndetësisë. A ka mundësi të presim pak, sepse nuk bëhen dokumentet strategjike të Komunës me zotime, drejtor. E bëjmë Planin Zhvillimor Komunal dhe inkuorporohet aty, e nuk ka nevojë që ky propozim të vijë fare në Kuvendin e Komunës për aprovim. Ndërsa për spitalin, ka nevojë por këtu duhet të na jepen sqarimet e nevojshme, a do të trajtohen vetëm pacientët e komunës sonë, apo nga e tërë Kosova. Pasi nuk ka spital të tillë në Kosovë, me siguri do të jetë për krejt vendin. A është i përshtatshëm ai lokacion për ndërtimin e atij spitali për t'i përballuar të gjitha nevojat e qytetarëve të Kosovës. Ju jeni përgjegjës për të caktuar lokacionin dhe për ta përshtatur atë me dokumentet ekzistuese, por kjo nuk është forma e duhur për ta përshtatur dhe për këtë arsye, ne nuk do ta votojmë. Nëse e votoni, uroj të kaloj, uroj që Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ta lejon.

Migjen Kolshi: Ne parimisht jemi për, por në këto kushte dhe rrethana drejtor, a do të guxojë të lëshojë leje ndërtimore?

Driton Ademi: Kjo temë ka një lloj ndjeshmërie dhe dhembshmërie pasi është shërbim humanitar dhe spitali plotëson një qëllim fisnik në atë fazën terminale për pacientët. Por në këtë rast ne po flasim specifikisht për lokacionin, është rregull që drejtori të dalë dhe ta elaborojë paraprakisht, sa i përket urbanizmit, a jemi në përputhje me dokumentet strategjike të komunës. Nëse dokumentet tona nuk janë në rregull dhe na i kthen Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, atëherë përgjegjësia bjen mbi ne, në rastin konkret, ne po presim që drejtori ta elaborojë dhe të tregojë pozicionin e Drejtorisë në këtë moment. Sa i përket pjesës nga Ministria e Shëndetësisë, ajo është diçka tjetër, sepse spitali është shërbim i nivelit terciar dhe nuk menaxhohet në nivelin komunal, por në nivel vendi dhe ne e kuptojmë rëndësinë e tij për pacientët në fazat terminale të jetës. Kështu që jemi ende të hendikepuar sa i përket votimit, derisa të elaborohet plotësisht nga Drejtori për Planifikim Urban.

Drejtori për Planifikim Urban: Përshëndetje i nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës, të nderuar asambleistë, propozimi ka të bëjë me caktimin e lokacionit për ndërtimin e spitalit dhe harmonizimin me dokumentet planifikuese. Ky projekt nuk është projekt i komunës sonë, ky është projekt i Ministrisë së Shëndetësisë. Ministria po kërkon një lokacion të përshtatshëm për këtë spital në nivel vendi. Ne duam ta harmonizojmë këtë kërkesë, në Planin Zhvillimor Komunal është caktuar lokacion, janë kërkuar sipërfaqet nga Ministria dhe është përmbushur ky kriter në ngastrën Kadastrale Nr. 713 në Sllatinë të Madhe, në zonën që parimisht njihet si 'Te Pishat'. Është një lokacion adekuat që i përmbush të gjitha kriteret për një spital të tillë. Në atë spital nuk trajtohen pacientët njëjtë, si në spitalet e rregullta, aty njerëzit kalojnë ditët e fundit të jetës së tyre. Prandaj, ata kanë nevojë për qetësi absolute dhe izolim në atë zonë. Projekti financohet nga Ministria e

Shëndetësisë dhe na kërkohet lokacioni pasi kemi bërë një marrëveshje ose memorandum. Komuna duhet të gjejë tokën ku do të realizohet ai projekt. A ka qenë kjo kërkesë e paraparë në vitin 2020 kur është punuar Harta Zonale e Komunës? Jo, sepse nuk ka ekzistuar si kërkesë, atëherë ne duhet t'i japim një mundësi këtij projekti dhe të krijojmë një mundësi. Kjo ndryshon nga Harta Zonale ekzistuese, sepse është një projekt unik që po ndodh për herë të parë në Kosovë. Diçka që ndodh për herë të parë, duhet t'i japim mundësinë e parë. Do të shpallet konkursi për dizajnimin e projektit, jo për ndërtimin direkt. Ky propozim nuk jep leje ndërtimi sot, ky propozim vetëm nis procedurat administrative. Ministria e Shëndetësisë pastaj vazhdon me procedurat e konkursit të projektimit, që merr kohë disa muaj deri në përzgjedhjen e projektit fitues. Gjatë asaj kohe, ne e kemi rregulluar dhe harmonizuar pjesën tonë me dokumentet e reja planifikuese. Por nëse presim një, dy apo tre muaj sa të miratohet Plani Zhvillimor Komunal komplet, ne po e prolongojmë fazën e projektimit, edhe për tre muaj të tjerë dhe kështu humbim komplet një vit për një document, të cilin mund ta shtyjmë përpara që sot si propozim. Kjo mbetet në dorën tuaj si Asamble e Komunës, por e keni në dorë mundësinë për të bërë një spital të tillë këtu dhe për të treguar, se çfarë mund të ofrojë komuna jonë shtetit.

Driton Ademi: Aktualisht ku është propozim si drejtori, sepse Harta Zonale e Komunës nuk preket deri në vitin 2029-2030, sepse nuk është dokument strategjik për një ose tre muaj?

Drejtori për Planifikim Urban: Në momentin kur bëhet Plani Zhvillimor Komunal i ri, ligjërisht duhet të bëhet harmonizimi i Planit Zhvillimor me Hartën Zonale. Me dokumentin ekzistues po trajtojmë një projekt unik, një projekt që nuk ka qenë fare i paraparë apo i kërkuar më parë në Kosovë. Me çfarë dokumenti keni mundur ta parashikoni këtë më herët. Sipas logjikës suaj, nëse nuk e bëjmë ne 'Spitalin Hospice', cila Plan Zhvillimor apo Hartë Zonale në Kosovë e ka të paraparë aktualisht këtë spital, asnjëra.

Laureat Gojnovci: Në zonë të shërbimeve mundeni me e bërë.

Drejtori për Planifikim Urban: Në qytet është zona e shërbimeve, jo në mal, nëse e bën spitalin në Prishtinë, duhet me bërë në zonën e Gërmisë, sepse është park.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Drejtori e dha shumë mirë sqarimin, ne po flasim për një projekt që nuk ka ndodhë asnjëherë, po i japim hapat e parë këtij projekti, e miratojmë si lokacion, e parashikojmë në Planin Zhvillimor Komunal të ri dhe në Hartën Zonale të Komunës dhe pastaj fillojnë procedurat e tjera përmes Ministrisë së Shëndetësisë.

Laureat Gojnovci: Me drejtorin pajtohem, por në asnjë moment nuk na u tregua hapi i saktë, se si do të bëhet harmonizimi me dokumentet ekzistuese, çka duhet të bëjmë në këtë moment që të mos kthehet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ky është qëllimi. Ne duhet të ndërhyjmë në hartë zonale ose duhet ta presim Planin Zhvillimor Komunal, është rast unik që nuk është paraparë prandaj janë dokumentet strategjike. Unë gëzohem që sa parë të vijë në shqyrtim Plani Zhvillimor dhe ta kalojmë, sepse i jep një orientim tjetër Fushë-Kosovës. Nëse drejtor na bind që do ta harmonizosh me dokumentet ekzistuese ne do ta votojmë, por nuk mundeni pa ardhur Plani Zhvillimor Komunal. Ajo zonë është park rekreativ, a mundemi ta dërgojmë në një vend që është më i izoluar. Nëse na bindni që është në harmoni me ligjin, ose që do të mund të harmonizohet pa na u kthyer mbrapsht, ne e votojmë.

Drejtori për Planifikim Urban: Është pikë shumë e ndjeshme dhe e arsyeshme, siç u tha, ngastra kadastrale konkrete në Planin Zhvillimor Komunal të ri është planifikuar specifikisht për këtë çështje. Po flasim për një projekt të shtetit, në tokë të shtetit, për të mirën e qytetarëve. Unë ju kisha thënë të gjithëve jepni një mundësi këtij projekti. Nëse Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e kthen mbrapsht, atëherë do të diskutojmë prapë se pse u refuzua.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë drejtor, atëherë po e qesim në votim pikën e katërt të rendit të ditës: Propozim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Spitalit Hospice dhe harmonizimin me dokumentet planifikuese.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim gjithsej pesëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim, nga njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës në mungesë të pjesëmarrjes në votim nuk e aprovon 'Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Spitalit Hospice dhe harmonizimin me dokumentet planifikuese'.

Pika e pestë (5) - Shqyrtimi i dytë i Projekt-Planit Lokal të Veprimet për Barazi Gjinore në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2026-2028.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Diskutimi publik është mbajtur, ndryshime përmbajtësore nuk ka patur, andaj e marrim qëndrimin e Grupeve Parlamentare.

Kosovar Ademi: Në emër të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim për aprovim në shqyrtimin e dytë 'Planin Lokal të Veprimet për Barazi Gjinore në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2026-2028'.

Laureat Gojnovci: Në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e përkrahim për aprovim në shqyrtimin e dytë 'Planin Lokal të Veprimet për Barazi Gjinore në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2026-2028'.

Migjen Kolshi: Në emër të Grupit Parlamentarë të Partisë Demokratike të Kosovës, e përkrahim për aprovim në shqyrtimin e dytë 'Planin Lokal të Veprimet për Barazi Gjinore në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2026-2028'.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim në shqyrtimin e dytë 'Planin Lokal të Veprimet për Barazi Gjinore në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2026-2028'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me unanimitet të votave u aprovua në shqyrtimin e dytë 'Plani Lokal të Veprimet për Barazi Gjinore në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2026-2028' dhe mori:

V E N D I M

1. Për miratimin e 'Planit të Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2026-2028 në Komunën e Fushë-Kosovës'.
2. Plani i Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2026-2028 në Komunën e Fushë Kosovës, i cekur në paragrafin 1 të këtij vendimi, parasheh zbatimin nga institucionet komunale nga programet e punëve dhe aktiviteteve për barazi gjinore.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është 'Plani i Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2026-2028 në Komunën e Fushë-Kosovës', i cili financohet nga Buxheti i Komunës së Fushë-Kosovës dhe donatorët.

Pika e gjashtë (6) - Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores për lëshimin e lejes për instalimin e paneleve fotovoltaike.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Kjo pikë del në debat publik, materialin e keni para vetës, unë po e hapi diskutimin.

Kosovar Ademi: Në emër të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim çdo iniciativë e cila promovon energjinë e pastër dhe burimet alternative të energjisë të thjeshtësuara për qytetarët. Andaj jemi për aprovimin e këtij propozimi.

Laureat Gojnovci: Në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e përkrahim për aprovim në parim për diskutim publik 'Projekt-Rregulloren për lëshimin e lejes për instalimin e paneleve fotovoltaike'.

Migjen Kolshi: Në emër të Grupit Parlamentarë të partisë Demokratike të Kosovës, e përkrahim për aprovim në parim për diskutim publik 'Projekt-Rregulloren për lëshimin e lejes për instalimin e paneleve fotovoltaike'.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim në shqyrtimin e parë për diskutim publik 'Projekt-Rregulloren për lëshimin e lejes për instalimin e paneleve fotovoltaike'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje. Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me unanimitet të votave u aprovua në shqyrtimin e parë për diskutim publik 'Projekt-Rregullorja për lëshimin e lejes për instalimin e paneleve fotovoltaike' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin në parim për diskutim publik të 'Projekt-Rregullores për lëshimin e lejeve për vendosjen e paneleve foto-voltaikë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.
2. Projekt-Rregullorja për lëshimin e lejeve për vendosjen e paneleve foto-voltaikë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e lëshimit të lejeve për vendosjen e paneleve foto-voltaikë.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Rregullorja për lëshimin e lejeve për vendosjen e paneleve foto-voltaikë.

Pika e shtatë (7) - Shqyrtimi i parë i Projekt-Planit Lokal të Veprimit për avansimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2026-2029.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E hapim diskutimin për shqyrtimi i parë të 'Projekt-Planit Lokal të Veprimit për avansimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2026-2029'.

Kosovar Ademi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizje Vetëvendosje, e përkrahim për aprovim në shqyrtimin e parë për diskutim publik 'Projekt-Planit Lokal të Veprimit për avansimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2026-2029'.

Laureat Gojnovci: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e përkrahim për aprovim në shqyrtimin e parë për diskutim publik 'Projekt-Planit Lokal të Veprimit për avansimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2026-2029'.

Migjen Kolshi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Partisë Demokratike të Kosovës, e përkrahim për aprovim në shqyrtimin e parë për diskutim publik 'Projekt-Planit Lokal të Veprimit për avansimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2026-2029'.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim në shqyrtimin e parë për diskutim publik 'Projekt-Planin Lokal të Veprimit për avansimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2026-2029'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje. Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me unanimitet të votave u aprovua në shqyrtimin e parë për diskutim publik 'Projekt-Planin Lokal të Veprimit për avansimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2026-2029' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të 'Projekt-Planit të Veprimit Komunal për avancimin e të drejtave të komuniteteve Romë, Ashkalinjë dhe Egjiptian të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2026-2029'.
2. Projekt-Planin e Veprimit Komunal për avancimin e të drejtave të komuniteteve Romë, Ashkalinjë dhe Egjiptian të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2026-2029', e cekur në pikën një të këtij vendimi, cakton objektivat për avancimin e të drejtave të komuniteteve për periudhën katër vjeçare në territorin e komunës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Plani i Veprimit Komunal për avancimin e të drejtave të komuniteteve Romë, Ashkalinjë dhe Egjiptian të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2026-2029.

Pika e tetë (8) - Propozim për shqyrtimin e Kërkesave të Shoqatave të Veteranëve dhe Invalidëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Nr. 01-104/02-0005477/26 dhe Nr. 01-104/02-0003204/26 për lejimin e mjeteve financiare.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Vendimet janë të ndara për të dyja Shoqatat nga 9,500.00€ për Veteranë dhe Invalidë të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Mjetet financiare do t'i japin Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Zyra e Kryetarit të Komunës. Tani e qesim në votim kërkesën e parë për Shoqatën e Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje. Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me unanimitet të votave u aprovua 'Kërkesa me Nr. 01/104-02/000547726, të datës 24.02.2026, e Shoqatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës - Dega në Fushë-Kosovë', për lejimin e mjeteve financiare në shumën e përgjithëshme prej: 9,500.00€, nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin 'Kërkesës me Nr. 01/104-02/000547726, të datës 24.02.2026, të Shoqatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës - Dega në Fushë-Kosovë', për lejin e mjeteve financiare në shumën e përgjithëshme prej: 9,500.00€, nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve, në kode e nën -programeve si vijon:
 - 1.1 Në Zyrën e Kryetarit të Komunës Nr. 16002;
 - 1.2 Drejtoria e Shëndetësisë - Administrata Nr. 73011 dhe
 - 1.3 Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit - Shërbimet Kulturore Nr. 85002.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe sigurimin e mjeteve financiare të evidentuara në paragrafin 1, nënparagrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Shëndetësisë e Mirëqenies Sociale, Drejtorisë së Kulturës Rinisë e Sportit dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.

Tani e qesim në votim Kërkesën e dytë për Shoqatën e Invalidëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje. Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me unanimitet të votave u aprovua 'Kërkesa me Nr. 01/104-02/0003204/26, të datës 30.01.2026, të Shoqatës së Invalidëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës - Dega në Fushë-Kosovë', për lejin e mjeteve financiare në shumën e përgjithëshme prej: 9,500.00€, nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin 'Kërkesës me Nr. 01/104-02/0003204/26, të datës 30.01.2026, të Shoqatës së Invalidëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës - Dega në Fushë-Kosovë', për lejin e mjeteve financiare në shumën e përgjithëshme prej: 9,500.00€, nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve, në kode e nën -programeve si vijon:
 - 1.1 Në Zyrën e Kryetarit të Komunës Nr. 16002;
 - 1.2 Drejtoria e Shëndetësisë - Administrata Nr. 73011 dhe
 - 1.3 Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit - Shërbimet Kulturore Nr. 85002.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe sigurimin e mjeteve financiare të evidentuara në paragrafin 1, nënparagrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Shëndetësisë e Mirëqenies Sociale, Drejtorisë së Kulturës Rinisë e Sportit dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.

Pika e nëntë (9) - Rishqyrtimi i vendimit Nr. 65, të datës 24.02.2026, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë- Kosovë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Rekomandimi i Ministrisë është që duhet të vjen në rishqyrtim, e keni materialin se ajo do të jetë në harmoni me Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale, e cila ka shkuar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe procedurat

e arsyetimit janë të njëjta, rishqyrtimi plotësohet me zotimin që ka ardhur prej Drejtorisë së Planifikimit Urban.

Kosovar Ademi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim plotësimin e vendimit të cekur në propozim me zotimin që ka ardhur prej Drejtorisë së Planifikimit Urban.

Laureat Gojnovci: Është e njëjta situatë sikur me Propozimin paraprak të këtij Ekzekutivi të Komunës, dua ta theksoj arsyetimin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e cila thotë: Nuk lejohet destinim apo shfrytëzshmëri tjetër nga ajo që parashihet me dokumentat e planifikimit hapësinor në fuqi. Tani kërkohet nga ajo çka u tha më lartë, të veprohet sipas 'Vlerësimit të ligjshmërisë të Aktit Komunal', nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm. Ju lutem merrni një vendim drejtë dhe të ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, sikur kërkohet. Në material na vjen një zotim i Drejtorit të Planifikimit Urban që thotë: Na kena me inkorporuar në Planin Zhvillimor Komunal, do të kthehet prapa. Vendimin na ka kthyer Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ndërsa zotimi i është bërë Ministrisë të Shëndetësisë, nuk bëhet më zotim drejtor, duhet me harmonizim ose me inkorporim në dokumentet zyrtare. Ju lutem kolegë lexojeni arsyetimin, do të na kthejnë prapa, sepse ata nuk merren me zotime.

Migjen Kolshi: Kryesues i Kuvendit të Komunës, tani z. Laureat Gojnovci i përmendi të gjitha shkeljet, ai vend është i papërshtatshëm, vendi ku ndërtohet 10 metra apo 40 metra më poshtë, janë bërë matjet që toka aty nuk ndërtohet mbi 1.5 metra.

Drejtori për Planifikim Urban: Këto ngastra kadastrale janë zonë e shërbimeve, zona e shërbimeve në hartat dixhitale kur klikon aty, është zonë e shërbimeve, një nën-titulli është për institucione shkollore. Për arsye që është zonë e shërbimeve, nuk do të thotë që duhet patjetër me u bërë veç shkollë, mundet të bëhet edhe një institucion tjetër në shërbim të qytetit. Zotimi bëhet për diçka tjetër, udhëkryqi ka me u ndërruar dhe është duke u ndërruar, kryqëzimi i rrugës, për arsye se qasja e qytetit prej Bresjes në Lagjen 028, nuk është udhëkryq që mundeni me kaluar në anën tjetër. Çka ndërrohet me ndërrimin e udhëkryqit, me ndërrimin e qasjes në rrugë, ngastra kadastrale e cila mbetet kryqëzim brenda zonës së shërbimeve, e cila është në Hartën Zonale të Komunës aktuale dhe e cila prapë se prapë ka me vazhduar në Planin Zhvillimor Komunal, e ka dallimin veç të rrugës. Kjo ka dallim nga Hospice, sa për leje ndërtimore sot e lëshoj sepse gjithë çka është në rregull.

Laureat Gojnovci: A mundem më ta bë një pyetje?

Drejtori për Planifikim Urban: Pa tjetër.

Laureat Gojnovci: Pyes, a është lexuar arsyetimi i Ministrisë përkatëse?

Drejtori për Planifikim Urban: Po, thotë: Nuk lejohet destinim apo shfrytëzim tjetër, nga ajo që parashihet në dokumentet e planifikimit hapësinor në fuqi dhe ne jemi duke bërë plotësim-ndryshim.

Driton Ademi: Është hera e parë që kthen Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor edhe që ne nuk e dimë epilogun e trajtimit të saj, nëse t'i mundesh me arsyetuar, ktheja Ministrisë së

linjës. Përndryshe, na duhet me shfuqizuar ose nuk duhet me zbatuar, se në momentin kur fillon me zbatuar, shkon në gjykatë, edhe gjykata ta ndalon.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë dua të jap një qëndrim, të nderuar kolegë Kuvendi i Komunës është arenë e tillë ku bëhen diskutime, jepen propozime, jepen ide, jepen sqarime, kundërshtime, por të gjitha duhet ta kemi parasysh një element, që të gjitha veprimet tona duhet të jenë në një synim, në të mirën e qytetarëve dhe me interesin e përgjithshëm të qytetarëve. Është një projekt që do t'i shërbej komunitetit që jeton në Komunën e Fushë-Kosovë. I dijmë vështirësitë ose pengesat procedurale të cilat po hasim, por qëllimi kryesor i yni është që t'i tejkalojmë këto procedura dhe këto pengesa dhe ta gjejmë mirëkuptimin në mes të nivelit lokal dhe atij qendror. Jam i sigurt që synimi i tillë ka qenë edhe nga pushtetarët e kaluar, të ndërtohet dhe qytetarëve tanë të kenë shërbime, sa më të mëdha, sa më të mira dhe sa më të duhura. Atëherë kjo çka është e paraqitur brenda nesh, është një zotim që po i bashkangjitet rishqyrtimit, sepse Ministria e linjës ka thënë rishqyrtojeni, ne e kemi pranuar rishqyrtimin, këtë rishqyrtim po i'a bashkangjisim një zotim, bashkë me këtë zotim po i'a kthejmë prapë Ministrisë së linjës dhe po i themi që këta po dojnë me ndërtuar në këtë vend. Zotimin po e jepim duke u bazuar në plotësimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për ndryshim - plotësimin e paragrafit një të vendimit Nr. 66, të datës 24.02.2026, mbështetur në Shkresën Nr. 830-2/2026, të datës 19.03.2026 për rishqyrtim, të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për lokacionin për ndërtimin e objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, me zotimin e Drejtorisë së Planifikimit Urban për përfshirjen e tij, në dokumentet e planifikimit hapësinorë'.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për' asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, nga gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të pjesëmarrësve në votim e aprovoi 'Propozimin për ndryshim - plotësimin e paragrafit një të vendimit Nr. 66, të datës 24.02.2026, mbështetur në Shkresën Nr. 830-2/2026, të datës 19.03.2026 për rishqyrtim, të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për lokacionin për ndërtimin e objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, me zotimin e Drejtorisë së Planifikimit Urban për përfshirjen e tij, në dokumentet e planifikimit hapësinorë' dhe mori:

V E N D I M

1. Për ndryshim - plotësimin e paragrafit një të vendimit Nr. 66, të datës 24.02.2026, mbështetur në Shkresën Nr. 830-2/2026, të datës 19.03.2026 për rishqyrtim, të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për lokacionin për ndërtimin e objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, sipas Planit të Veprimit të Hartës Zonale të Komunës për vitet 2020-2028, ku kapacitetet për plotësimin e nevojave në arsim për zonën e shërbimeve në lagjen e Bresjes janë të plotësuara për kokë të numrit të nxënësve dhe propozohet ngritja e nevojshme e kapaciteteve dhe ofrimit të shërbimeve shëndetësore, me lejin e zëvendësimit të situacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, në tre ngastrat kadastrale si vijon:

- 1.1 Ngastra Kadastrale Nr. P - 72514036- 01380-0, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, pronë e komunës në sipërfaqe prej: S = 2985 m²;
- 1.2 Ngastra Kadastrale Nr. P - 72514036- 01379-0, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, pronë e komunës në sipërfaqe prej: S = 1031 m² dhe
- 1.3 Ngastra kadastrale Nr. P - 72514036- 01378-0, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, pronë e komunës në sipërfaqe prej: S = 573 m².
2. Pas paragrafit një shtohet, paragrafi dy për lokacionin për ndërtimin e objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, me zotimin e Drejtorisë së Planifikimit Urban - Komunës së Fushë-Kosovës, për harmonizimin e tij edhe me dokumentin e planifikimit hapësinor i definuar sipas nenit 5, paragrafi 1.2, nën paragrafi 1.2.1 - Planin Zhvillimor Komunal, në bazë të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174.

Pika e dhjetë (10) - Shqyrtimi i Kërkesës Nr. 02-070/05-0015252/26 të datës 25.05.2026, për lejimin e ndihmës financiare për Shoqatën e Kosovës për Kërkim-Shpëtim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Nëse kalon kjo kërkesë për ndihmë financiare, shuma që do të aprovohet është 9,500.00€ dhe do të merret nga kodet e financimit të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, prej kategorisë së subvencioneve dhe transfereve.

Kosovar Ademi: Shoqata për kërkim dhe shpëtim, kryen një profesion fisnik dhe human, kjo shoqatë kryen shumë punë në baza vullnetare, në tre vitet e fundit, e dijmë që i kanë patur disa intervenime dhe i kanë evakuuar disa familje në fshatra të ndryshëm. Është obligim moral i jonë t'i japim mbështetje në veprimtarinë e tyre që ata bëjnë brenda komunës sonë.

Laureat Gojnovci: Kryesues i Kuvendit të Komunës dua ta bëjë një pyetje, a është në rregull me ardhur pika të rendit të ditës, pa asnjë sqarim edhe pa asnjë artikullim, se pse duhet me i votuar atëherë ne.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Jo, nuk është në rregull.

Laureat Gojnovci: Pajtohem me ty, po e shoh Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, besoj që mundet me na dhënë një arsyetim pse duhet të më i'a dhënë këtë mjete financiare, edhe pse sidomos pas vizitës së z. Naim Bardiqi tek kjo shoqatë. Nëse shtyhet për mbledhjen e ardhshme, do ta votojmë edhe ne, nëse janë mjetet financiare janë edhe mbi 20,000.00€, po jo në kohën e fushatës për të marrë vota z. Naim Bardiqi.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Kjo është një paralele sikurse me thënë po i jepni pare tani Shoqatës të invalidëve dhe veteranëve në kohët e fushatës, kjo qasje e juaja nuk qëndron.

Migjen Kolshi: Kryesues i Kuvendit të Komunës, unë nuk pajtohem të krahasohet kjo shoqatë me invalidët dhe veteranët e luftës dhe po mendojmë që e keni për fushatë dhe ne nuk e votojmë në këtë mbledhje.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Po ju siguroj se nuk ka tendencë politike për këtë kërkesë.

Kosovar Ademi: Tani ju z. Migjen Kolshi, theksuat që janë barazuar dy kategori, po kjo kategori e Organizatës së Veteranëve të Luftës për njëzet vite, a ka përfituar ndonjë gjë substanciale nga komuna jonë.

Migjen Kolshi: Po, ka më shumë se një rast kur ky Kuvend i Komunës ka ndarë buxhet për Organizatën e Veteranëve të Luftës, gjithashtu u ka ofruar edhe automjetë që ta kenë më të lehtë funksionimin si organizatë.

Kosovar Ademi: Kur ndihmohet një shoqatë, pse duhet të penalizohet tjetra.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: tani po e qesim në votim 'Kërkesën me Nr. 02-070/05-0015252/26, të datës 25.05.2026, të Shoqatës së Kosovës për Kërkim dhe Shpëtim', për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 9,500.00€, nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për' asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, nga gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të pjesëmarrësve në votim e aprovoi 'Kërkesën me Nr. 02-070/05-0015252/26, të datës 25.05.2026, të Shoqatës së Kosovës për Kërkim dhe Shpëtim', për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 9,500.00€, nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin 'Kërkesës me Nr. 02-070/05-0015252/26, të datës 25.05.2026, të Shoqatës së Kosovës për Kërkim dhe Shpëtim', për lejimin e mjeteve financiare në shumën e përgjithëshme prej: 9,500.00€, nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve, në kode e nën -programeve si vijon:
 - 1.1 Në Zyrën e Kryetarit të Komunës Nr. 16002;
 - 1.2 Drejtoria e Shëndetësisë - Administrata Nr. 73011;
 - 1.3 Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit - Shërbimet Kulturore Nr. 85002 dhe
 - 1.4 Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit - Infrastruktura Publike Nr. 18162.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe sigurimin e mjeteve financiare të evidentuara në paragrafin 1, nënparagrafët 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Shëndetësisë e Mirëqenies Sociale, Drejtorisë së Kulturës Rinisë e Sportit, Drejtorisë së Shërbimeve Publike e Mjedisit dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.

Pika e njëmbëdhjetë (11) - Propozim për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të komunës në Planin Komunal për Gjithpërfshirje Sociale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Kërkohen emrat nga tri subjektet politike dhe nga subjektet politike të cilat përfaqësohen më një anëtarë në Kuvendin e Komunës. Hap diskutimin.

Kosovar Ademi: Ne propozojmë znj. Arlinda Mekolli për anëtare, në përgatitjen e Projekt-Planit Komunal për Gjithpërfshirje Sociale.

Laureat Gojnovci: Ne propozojmë znj. Saranda Sllamniku për anëtare, në përgatitjen e Projekt-Planit Komunal për Gjithpërfshirje Sociale.

Migjen Kolshi: Ne propozojmë znj. Aida Alimi për anëtare, në përgatitjen e Projekt-Planit Komunal për Gjithpërfshirje Sociale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë, nga subjektet politike të cilat përfaqësohen më një anëtarë në Kuvendin e Komunës, propozohen z. Gjëlbrim Halili dhe nga komunitetet z. Dashnim Bajrami. Tani emrat e propozuar më lartë i qesim në votim për aprovim.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje. Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi 'Për caktimin e anëtarëve të Grupit Punues për hartimin e Planit Komunal për Gjithëpërfshirje Sociale në Komunën e Fushë-Kosovës në përbërje prej pesë anëtarëve të cekur më lartë' dhe mori:

V E N D I M

1. Për caktimin e anëtarëve të Grupit Punues për hartimin e Planit Komunal për Gjithëpërfshirje Sociale në Komunën e Fushë-Kosovës në përbërje prej pesë anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Arlinda Mekolli - përfaqësuese e Lëvizjes Vetëvendosje, anëtare;
 - 1.2 Saranda Sllamniku - përfaqësuese e Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtare;
 - 1.3 Aida Alimi - përfaqësuese e Partisë Demokratike të Kosovës, anëtare;
 - 1.4 Xhelbrim Halili - përfaqësues i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, anëtar dhe
 - 1.5 Dashnim Bajrami - përfaqësues i Partisë Demokratike të Ashkalinjëve të Kosovës, Anëtar.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Grupit Punues është hartimi i Projekt-Planit Komunal për Gjithëpërfshirje Sociale të Komunës së Fushë-Kosovës, konform dispozitave ligjore në fuqi për fushën përkatëse dhe për punën e tij Kuvendit të Komunës.

Pika e dymbëdhjetë (12) - Të Ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Atëherë faleminderit, me qenë se nuk kemi asgjë tek 'Te Ndryshmet, po e mbyllim mbledhjen dhe urime Festa e Kurban Bajramit, shihemi në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 16:40h.

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani

